

Ftesë për Shprehje Interesi

PËR SHËRBIMIN E MATERIALIZIMIT TË KANALEVE TË RTK-së NË PLATFORMAT ONLINE

Radio Televizioni i Kosovës duke u bazuar në Ligjin për RTK–në, publikon ftesën për shprehjen e interesit për materializimin e kanaleve të RTK-së në platformat online.

Kompanitë të cilat janë të interesuara të ofrojnë zgjidhje teknike dhe financiare duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:

- Të ofrojnë dëshmi për kapacitete teknike dhe financiare për të monetizuar asetet digjitale të RTK-së në Facebook, Youtube, Instagram, TikTok, Spotify, Web faqen RTKLIVE si dhe platformat e reja ku RTK është e pranishme;
- Të përshkruajnë në detaje ofertën/kapacitetet teknike për shërbimet respektive dhe mbrojtjen e kanaleve/aseteve të RTK-së;
- Të përshkruajnë në detaje ofertën e tyre financiare;
- Të sjellin 3 referenca për punën në Youtube dhe platforma tjera gjatë tri viteve të fundit;
- Të jenë në gjendje t'i mbrojnë materialet e RTK-së kundër piraterisë në platformat online;
- Të dorëzojnë certifikatën e regjistrimit të biznesit nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve;
- Të dorëzojnë certifikatën e numrit fiskal;
- Të sjellin vërtetim nga administrata tatimore e Kosovës (ATK) për kryerjen e obligimeve tatimore;
- Të kenë pasur qarkullim financiar së paku 200,000 në dy vitet e fundit (kombinuar);
- Të kenë mundësi asistimi ligjor në Bashkimin Evropian, Zvicër, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- Të ofrojnë sigurim të ekzekutimit të kontratës, të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimit e licencuar në Republikën e Kosovës, në vlerë 50,000 Euro me validitet 37 muaj pas datës së parashikuar të nënshkrimit të kontratës (11.12.2022);

RTK ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe dokumentacion shtesë nga kompanitë ofertuese nëse është e nevojshme, në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i saktë.

Kërkesa për shprehjen e interesit, duhet të dorëzohet në kuvertë të mbyllur, duke filluar nga 22.11.2022 deri më 02.12.2022 në ora 16:00, në zyrën e Administratës, Kati i 3-të, # 77 në ndërtesën e Radiotelevizionit të Kosovës, Rr: “Xhemajl Prishtina” Nr 12 Prishtinë.

Për çdo informatë mund të kontaktoni përmes adresës elektronike: youtube@rtklive.com